



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr 2567/2023  
Data: 22.02.2023

### PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e -II- dytë për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27.02.2023 me fillim pune në ora 10:30 në sallën e takimeve. Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete. Prezent ishin : **Natyra Kalisi** (Drejtore për Administratë) **Bashkim Sopa** (Zyrtar për informim) **Avni Bushi** ( Sekretar i lartë i Kuvendit) **Visar Hasallari** (KVRL)

### RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Takim me Drejtorinë e Administratës
- 3.Identifikimi dhe parandalimi i dukurive negative në Komunën e Hanit te Elezit
- 4.Eventuale.

### U MIRATUA RENDI I PUNËS

#### 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## **2.Takim me Drejtorinë e Administratës**

**Kryesuesi thekson:-** Sherbimet e administratës lidhur me zyren e prokurimit ku flitet që zyra e prokurimit nuk i kryen punët , menaxhimi i automjeteve , numri i punotorëve, rexhistrimi dhe mbatja e materialit zyrtar ,pranimi i llaptopave dhe dorezimi sepse kam degjuar që pushteti i kaluar nuk i ka dorezuar llaptopat , mirëmbajtja e teknologjisë informative a mungon diqka , informatë rrith punëve te gjendja civile ?

**Natyra Kalisi** thekson: Fillimisht ju falenderoj që më keni ftuar në këtë takim, unë besoj që kjo formë e takimeve është shumë e qëlluar pasi që njoftoheni nëpër dikastere përkatësë për punët dhe aktivitetet, por fillimisht para se të përgjigjem në pyetjet e juaja më lejoni të tregoj përgjegjësitë e kesaj drejtorie e cila është përgjegjëse për:

Kujdeset për funksionimin e administratës komunale përfshirë shërbimin e kuvendit dhe të ekzekutivit të komunës

Mbikëqyrë sektorin e Ofiqarisë dhe gjitha shërbimet që kryen ky sektor në pajtim me ligjin e Kuvendit të Republikës së Kosovës që tregullon këtë sektor.

Kujdeset për funksionimin e Zyrës Pritëse dhe Arkivisë - K...

Kujdeset për funksionimin e Zyres Pritese dhe Arkivin e Komunës së Kukësit

Kujdeset per funksionimin e shërbimeve logistike duke përfshirë transportin,depon,postën,inventarin,shërbimin e sigurimit, përkthimin e dokumenteve zyrtare,mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë informative dhe mirëmbaitjen e objekteve

Eshtë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe transparencën e Shërbimit Civil Komunal, mirëmbajtjen e ëeb fages Komunale si dhe freskimin e saj.

Është përgjegjës për sigurimin e transparencës dhe respektimin e të drejtave të njeriut, Ofrimin e bashkëpunimit, këshillave Dhe ndihmës profesionale drejtoreve tjera mbi të gjitha çështjet administrative Kryen edhe punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe të përcaktuara me ligi.

Në përgjithësi, Drejtoria e administratës ka përgjegjësi të rëndësishme në menaxhimin e aktiviteteve administrative të organizatës.

Lidhur me pyetjen për zyrën e prokurimit, ju njoftoj se ata kanë përgjegjësi të japid reportim tek Kryetari i Komunës, sa i pëket çështjeve që lidhen me drejtorinë e administratës ka vonesa mirëpo janë ndoshta edhe procedurat që kërkojnë kohë.

Menaxhimi i automjeteve funksionin në rrëgull, besoj që gjatë muajve të ardhshme do të shpallim edhe procedurën për vendosjen e gps-ve që të mos keqpërdoren automjetet si nga ana e lokacioneve, vendparkimeve, shpejtësisë etj.

Në gjendjen civile vazhdimisht kemi kërkesa të cilat janë rutinore dhe ne si drejtori përgadisim raporte për statistika të cilat i përcjellim në ASK për numrin e lindjeve, vdekjeve, martesave etj.

Gjatë vitit 2022 janë lëshuar 6084 cerifikata të llojeve të ndryshme.

Në qendrën për shërbim më qytetarë apo në zyrën pritësë janë regjistruar 10537 lëndë.

Në sektorin e Kuvendorit Komunal funksionojmë në rregull, pasi që në këtë sektor përcillen informatat nga drejtoritë/njësitet për ti dërguar materialet dhe nuk është që nuk kemi vonesa por janë me qëllim të ofriut të informacioneve/raporteve/rregulloreve sa më të sakta.

Për pyetjen e laptopëve nga ish ekzekutivi është e vertet që nuk i kanë dorëzuar laptopët që i kanë përdorur sepse janë thirr në një vendim të kuvendorit i cili ka qenë i paligjshëm dhe kanë kërkuar që të shfuqizohet pasi që e njëjta bëhet nga Kryetari i Komunës, dhe i njëjti është bërë me qëllim që janë bërë edhe amortizimi i 4viteve përdorim të laptopëve.

Në teknologjinë informative jemi mirë nuk çalojmë deri më tani në ndonjë aspekt, jemi duke punuar në disa ndryshime të vogla por të gjithë zyrtarët kanë qasje në rrjet si qeveritar/ për kompjuter ashtu edhe wireless pasi që më herët nuk kanë pasur.

**Kryesuesi** thekson:- Ne pregaditjen e materialeve të kuvendorit ka gabime gjuhsore a keni menduar që në të ardhmen të merrni një gazetar apo gjuhtar që i rregullon materialet sepse kur e lexojm ka gabime

A është e vertet qe me ardhjen e pushtetit te ri pushteti i kaluar në teknologji informatike i ka fshir të gjitha memoriet?

**Natyra Kalisi** : sa i perket gjuhtarit apo gazetar ne nuk kemi ,mundohemi në maksimum mos të bejmë gabime por edhe jemi duke punuar në këtë drejtim , në pytjen e dytë po është e vertet që janë fshir të dhënët në memorie e disa kompjuterëve .

**Zaim Bela** thekson:- Në pytjen për memoriet të kompjuterëve un si ish drejtor , e kam njoftuar drejtorin për të gjitha punët ,kisha një pytje për drejoreshën për shujtat a i'u takojnë stafit civil ?

**Natyra Kalisi** thekson:- Për shujtat e stafit të komunës ne i kemi procedu në dhjetor mirëpo nuk na kanë pranu ministria e financave përkundrazi vullnetit të Kryetarit të Komunës për ti kryej shujtat.

Zyrtarët sa kamë informacion kanë përcjell me procedura përmbarimore në dy forma me avokat dhe me zyrtarë komunal, mirëpo përshkak se shpenzime të shumta ne kemi dasht mi procedu me rregullë për shkak se shkon buxheti nga projektet kapitale dhe është problem për komunën pa projekte kapitale.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- Këshillave e fshatrave a jane duke funksionuar dhe a kan pas takime me bashkëfshatar.

**Natyra Kalisi:** Në lidhje me Këshillat Lokal ato funksionojnë kemi mbajtur gjatë vitit 2022 VI-të mbledhje të cilat janë të parapara më UA për funksionimin, organizimin dhe bashkëpunimin me vendbanimet, fshatrave dhe lagjeve. Pa modesti e them se jemi njëra nga Komunat e para në tërë Kosovën që i paguajmë këshillat lokal për mbledhjet që i mbajmë në takime.

Pas përfundimit të pyetjeve, drejtoresha tregoi për Planet për 2023:

1. Infografika në objektin e Komunës
2. Kamerat e sigurisë së qytetit dhe brenda objektit të komunës
3. Vendosja e GPS-ve në automjete komunale
4. Miratimi i planit për transparencë komunale
5. Aktivitetet me Këshillat Lokal trajnime,,
6. Raportime në ASK për gjendjen civile si dhe bashkëkoordinim për regjistrimin e popullësisë që fillon gjatë këtij viti.
7. Renovimi i ndriçimit të Brendshëm të komunës, pasi që atë përreth komunës e kemi rregulluar vitin e kaluar sepse nuk ka qenë në funksion.
8. Strategjia komunale per angazhimin dhe funksionimin e Këshillave Lokal

### **3.Identifikimi dhe parandalimi i dukurive negative në Komunen e Hanit te Elezit**

**Kryesuesi** thekson:- Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

**Ajnure Thaqi:-** Zakonisht në shkolla mbajme ligjerata lidhur me perdorimin e narkotikeve per parandalimin e tyre nga shoqeria jone

**Visar Hasallari** thekson :- Ju faleminderoj per ftesen sa i perket pikes Identifikimi dhe parandalimi i dukurive negative në Komunen e Hanit te Elezit , Ne KKSB gjithmone e kemi ngritur si qeshtje ne parandalimin e narkotikeve qe policia te merret sa me shume ne kete drejtim , tjetra eshte edhe perdorimi i lojrave te fatit qe ne shoqerin tone eshte bere dukuri negative ku ne kemi kerkuar qe te kemi bashkpunim sa me te madh me policinë

### **4.Eventuale.**

Nuk pati diskutime

Procesmbajtësja

Sara Berisha

